



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Ligjit për auditimin e brendshëm nr.03 /L-128, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit administrativ nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e sektorit publik si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1
Themelimi dhe Përbërja

Me këtë Vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Lipjanit (në vazhdim të tekstit Komiteti), në përbërje si vijon:

1. Fitim Sadiku, nga shoqëria civile, Kryesues,
2. Hasan Zeqiri, nëpunës civil, anëtar,
3. Burim Gashi, nëpunës civil, anëtar

Drejtori i njësisë së Auditimit të brendshëm të Komunës do të jetë Sekretar i Komitetit dhe do të ndjek të gjitha takimet.

Neni 2
Mandati i Komitetit

Mandati i Komitetit është 3 (tre) vjeçar , me të drejtë riemërimi, por jo më shumë se dy mandate rresht. Mandati i tyre fillestar duhet të jetë i shkallëzuar një, dy dhe tre vjeçar varësisht nga përbërja e Komitetit.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit

Komiteti do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat e nenit 6 të Ligjit për auditimin e brendshëm nr.03 /L-128 si dhe të dispozitave të neneve 4, 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit administrativ nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e sektorit publik.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit .

1Nr. 112-62328
Lipjan, më 20.11.2017

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

